



Pranuar / Dorezuar Primijeno/Prodato Received/Delivery	05-09-2022	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIPMSHCK	5157/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A. Nr. 644/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj – Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Rushit Kajtazi -Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 644/2022 të datës 21.07.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi

nga kundër organit të punësimit/Zyra e Kryeministrit, në çështjen juridike “Vlerësim i punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 05.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A. Nr. 644/2022, e datës 21.07.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. MBETET NË FUQI, Vlerësimi i datës 26.02.2022, për vlerësimin e periudhës provuese, për ankuesen

A r s y e t i m

Ankuesja sipas shkresave të lëndës e punësuar në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës (sipas projektit të burësishtëve), me datë 21.07.2022, me numër protokolli 4232/2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore, lidhur me vlerësimin përfundimtar të periudhës provuese të datës 22.06.2022, të cilin vlerësim sipas dëshmivë të lëndës e ka pranuar me datë 28.06.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.07.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Zyra e Kryeministrit. Ndërsa Këshilli me datë 01.08.2022, ka pranua nga Zyra e Kryeministrit, përgjigjen në kërkesë me numër protokolli: 4438/2022, se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr. 644/2022 të datës 21.07.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; e- maili i datës 29.06.2022; Formuari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 23.01.2022; Formuari për vlerësimin e rezultuarve në punë për periudhën provuese; e- maili i datës 17.06.2022; e- maili i datës 30.06.2022; ; e- maili i datës 04.01.2022, Kërkesë për takim i datës 07.07.2022; Përshkrimi i detyrave të punës; e- maili i datës 29.06.2022; e- maili i datës 26.03.2022; ; e- maili i datës 26.03.2022; ; e- maili i datës 29.03.2022; e- maili i datës 27.03.2022; ; e- maili i datës 27.01.2022; e- maili i datës 26.01.2022; e- maili i datës 14.03.2022; ; e- maili i datës 16.06.2022; Përgjigje në ankesë e datës 29.07.2022, me numër protokolli 4438/2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e *pabazuar*, sepse:

Bazuar në vlerësimin vjetor të datës 26.06.2022, për vlerësimin e periudhës provuese, për ankuesen Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar së ankueses i është bërë konfirmimi i marrëdhënies së punës, për pozitën „Zyrtare e Lartë për Asistencë Zhvillimore“, nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë Drejtori i Zyrës për Bashkëpunim dhe Zhvillim i Zyrës së Kryeministrit.

Ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankueses, lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën provuese, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstaton se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses, në rastin e konfirmimit të periudhës provuese, ka vepruar në pajtim me nenin 37, paragrafi 1,2,3,4, nën paragrafi 4.1 të Ligjit nr. 06/1 – 114 për Zyrarët Publikë, ku përcaktohet se “ 1. Nëpunësi që emërohet për herë të parë në Shërbimin Civil i nënshtrohet një periudhe prove, që zgjat një vit nga data e aktit të emërimit. Marrëdhënia e Shërbimit Civil për nëpunësin në periudhë prove është marrëdhënie nën kushtin zgjedhës të konfirmimit në fund të periudhës së provës; 2. Qëllimi i periudhës së provës është përgatitja teorike dhe praktike e nëpunësit për kryerjen me sukses të detyrave. 3. Gjatë periudhës së provës, nëpunësi kryen veprimtaritë e detyrueshme të trajnimit dhe kryen detyrat nën kujdesin e një nëpunësi civil të së njëjtës kategori, ose kategorie më të lartë, i cili përcaktohet nga mbikëqyrësi.4. Në fund të periudhës së provës, institucioni ku nëpunësi është i emëruar, mbështetur në vlerësimin e përgatitjes dhe vlerësimin e rezultateve të punës të nëpunësit për të kryer detyrate pozitës të punë, vendos: 4.1. konfirmimin e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil të nëpunësit ose mos konfirmimin, andaj në rastin konkret, Kolegji konstaton se ankueses sipas formularit për vlerësimin e rezultateve në punën provuese, i datës 22.06.2022, nga mbikëqyrësi i

drejtpërdrejtë i është konfirmuar mardhënia e punës në kuadër të shërbimit civil gjegjësisht në Zyrën e Kryeministrit në pajtim me Ligjin Nr. 06/1 - 114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë Drejtori i Zyrës për Bashkëpunim dhe Zhvillim i Zyrës së Kryeministrit, në vlerësimin e parë për gjashtë mujorin e parë ka qenë teje pozitiv, ndërsa në 6 (gjashtë) mujorin e dytë nuk kanë qenë të knaqëshme, por në bazë të disa imellavë mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ka sugjeruar se si duhet të vepronet në kuadër të detyrave të punës, ndërlidhur me këto komunikime, Kolegji konstaton se është mjaftueshëm konfirmimi i mardhënies së punës në kuadër të shërbimit civil gjegjësisht Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës për ankuesen.

Andaj, bazuar në konstatimin si me sipër, Kolegji vlerëson së udhëheqësi drejtpërdrejtë i ankueses me rastin e konfirmimit të periudhës provuese të ankueses ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejtë ligjin material, duke vepruar në pajtim me nenin 37, paragrafi 1,2,3,4, nen paragrafi 4.1 të Ligjit nr. 06/1 - 114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar ne nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafit 2 të Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA ME NUMËR A.NR. 644/2022**

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Zyrën e Kryeministrit, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së